

## Arben Berisha<sup>1</sup>

# VENDOSJA E POPULLATËS MUHAXHIRE NË GALLAPIN E PRISHTINËS

### ABSTRACT

The position of the Albanians during the Ottoman-Russian wars of 1877-1878 was very difficult, which put them in a very difficult position of survival. The Slavic peoples of the Balkans, supported by the Russian Empire, attacked Ottoman territories in the Balkans, forcing them to withdraw from the war-torn areas. Here the most injured were the local population or the Albanians, who were labeled as Turks and as such were looted, terrorized, killed and forced to move from their lands.

This paper reflects the settlement of the migrant population in Gallapin of Pristina and their movements through this territory looking for a suitable space and better conditions to live. Their decision to live in this area happened when they realized that they could no longer return to their earlier land. The emigrants settled in Gallap may not all be from the war that took place during the years 1877-1878, but among them there are families who have faced the first migrations that took place even earlier from the Pashallek of Belgrade and that were settled in Sanjak of Nishi, and finally together with the population from Vranja, Nishi, Leskofci, etc. are forced to move in the direction of Kosovo, where the first station of their settlement was certainly the Gallapi of Pristina, where they try to find shelter first and then seek better living conditions. This, of course, was not easy, because they were settled on the lands of the previous owners, and with this the pastures were reduced, etc. Many of the immigrants, who were economically better off, did not stop in Gallap but continued to Skopje and many others to Turkey.

**Keywords:** *Muhaxhira, settlement, village, family.*

### ABSTRAKT

Pozita e shqiptarëve gjatë luftërave osmane-ruse të viteve 1877-1878 ishte shumë e rënd, e cila i dërgonte ata në një pozicion mjaft të vështirë mbijetese. Popujt sllavë të Ballkanit, të mbështetura nga Perandoria Ruse, sulmuan territoret osmane në Ballkan duke i detyruar që të tërhiqen nga zonat që përfshiu lufta. Këtu më të dëmtuarit ishin popullata vendase apo shqiptarët, të cilët ishin etiketuar si turq dhe si të këtille u plaçkiten, u terrorizuan, u vranë dhe i detyruan të shpërngulen nga trojet e tyre.

Në këtë punim pasqyrohet vendosja e popullatës muhaxhirë në Gallapin e Prishtinës dhe lëvizjet e tyre nëpër këtë territor duke kërkuar një hapësirë të përshtatshme dhe kushte më të mira për të jetuar. Vendosja e tyre për të jetuar në këtë zonë ndodhë atëherë kur e kuptojnë se më nuk mund të ktheheshin në tokën e tyre të më hershme. Muhaxhirët e vendosur në Gallap mund edhe të mos jenë të gjithë të luftës së ndodhur gjatë viteve 1877-1878, por që në mesin e tyre ka familje të cilat janë ballafaquar edhe më herët me shpërnguljet e para të ndodhura qysh nga Pashallëku i Beogradit e që ishin vendosur në Sanxhakun e Nishit, e së fundi bashkë me popullatën nga Vranja, Nishi, Leskofci, etj. detyrohen të lëvizin në drejtim të Kosovës, ku stacioni i parë i vendosjes së tyre sigurisht se ishte edhe Gallapi i Prishtinës ku përpqen të strehohen fillimisht dhe pastaj të kërkojnë kushte më të mira për jetesë. Kjo sigurisht se nuk ka qenë e lehtë, sepse ata janë vendosur në tokat e pronarëve të më hershëm, e me këtë u bë zvogëlimi i kullosave, etj. Shumë nga muhaxhirët, të cilët qëndronin ekonomikisht më mirë, nuk u ndalën në Gallap por vazhduan për në Shkup e shumë të tjerë drejt Turqisë.

**Fjalët kyçe:** Muhaxhirë, vendosje, fshati, familje.

---

<sup>1</sup> PhD Candidat, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Republika e Kosovës. Fakulteti Filozofik, Departamenti: Histori, Niveli i studimeve Phd. Mob. . +38344458727, Email. [hetiti@hotmail.de](mailto:hetiti@hotmail.de) & [arben.berisha9@student.uni-pr.ed](mailto:arben.berisha9@student.uni-pr.ed), Oricid: [0009-0002-5754-6736](https://orcid.org/0009-0002-5754-6736)

## Hyrje

**P**unimi “*Vendosja e Popullatës Muhaxhirë në Gallapin e Prishtinës*” synon të paraqesë një pasqyrë të shkurtër po të qartë të zhvillimeve shoqërore-ekonomike të muhaxhirëve shqiptarë të vendosur zonën apo krahinën e njohur si Gallap e në veçanti në atë të Gallapit të Prishtinës, pasi që dihet se Gallapi është një teren më i gjerë gjeografik, që përfshinë edhe Komunën e Novaberdës dhe një pjesë bukur të madhe të Komunës së Kamenicës. Këtu do të paraqesim vendosjen e familjeve muhaxhire dhe vendin nga kanë ardhur, ku janë vendosur ata, numrin e familjeve. Ne kemi arritur të nxjerrim edhe shifra të përafërta të numrit të familjeve po ashtu si dhe numrin e tyre të vendosur nëpër fshatra. Një gjendje të tillë përshkruese nuk e kemi gjetur në asnjë literaturë.

Materiali i shfrytëzuar për këtë punim është monografia e Ali. Sh. Berishës “Gallapi i Prishtinës II”, i cili është mbështetur kryesisht në intervistat e zhvilluara në Gallap, burimi tjetër i shfrytëzuar është katalogu i ekspozitës “Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78” përgatitur nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, që ka shërbyer për të bërë identifikimin e vendbanimeve të muhaxhirëve të mbetur nën okupimin serb dhe që u vendosën përkohësisht dhe përgjithnjë në Gallapin e Prishtinës, pastaj me çështjen e muhaxhirëve janë marrë edhe Dr. Sabit Uka, Dr. Jusuf Osmani, etj.

Mbetet që të pasqyrohet akoma më shumë në historiografinë shqiptare gjendja e luftës së viteve 1877-1878, shpërngulja e shqiptarëve nga trojet e tyre, vendosja e tyre në Gallap dhe kudo në Kosovë, lëvizjet e tyre brenda Kosovës, largimi i tyre në drejtim të Shkupit e të Turqisë, etj.

## Muhaxhirët në Gallapin e Prishtinës

Popullsia shqiptare e shpërngulur nga fshatrat e rrethit të Prokuples, Vranjes, Leskovcit, Nishit, u vendosën në Rrafshin e Kosovës, ndërsa në Gallapin e Prishtinës u vendosën kryesisht familje të shkëputura nga grupi, por që edhe këtu në zonat ku u vendosën bartën me vete edhe emrin e fshatit nga vinin. Nga Prishtina e deri në kufirin administrativ që e ndanë Kosovën nga Serbia, që është aftësisht 30 kilometra, e në veçanti banorët e fshatrave përgjatë kufirit nga Fshati Bërvenik e deri në fshatin Hajkobillë u ballafaquan me mjerimin e thellë të banorëve shqiptarë, që prapa kishin lënë fshatrat e tyre të djegura, shtëpitë e plaçkitura e të boshatisura, familjarë të persekutuar, dhunuar e të vrarë, shumë sish që vdiqën rrugës së ikjes, që përveç armikut gjakatar kishin edhe motin e acartë. Ata që ia arritën të depërtonin fillimisht u vendosën në zonat e Gallapit sa për tu çlodhur dhe rimarrë vetën.

Në Gallapin e Prishtinës është vështirë të dëgjosh se një familje muhaxhire, grup familjesh apo edhe individ të ardhur dhe vendosur të mos ketë lëvizur nga vendi ku

ishin vendosur fillimisht. Shumë prej tyre kanë ndërruar vendbanimet deri në 5 apo 6 herë për arsye të mos organizimit të pritjes dhe strehimit nga pushteti i atëhershëm në Prishtinë, apo diku tjetër. Popullata filloi të stabilizohet paksa me largimin e ushtrisë serbe përtej kufirit të vendosur sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, andaj edhe popullata vendase arriti t’iu ofrojë mikpritje. Edhe zotërinjtë e asaj kohe që kanë poseduar toka, filluan t’iu ndajnë ngastra me qëllim të shfrytëzimit, andaj muhaxhirët u cilësuan edhe si çipçinj. Por, kishte edhe raste kur vendorët iu ofronin muhaxhirëve strehë për vite të tëra.<sup>1</sup>

Muhaxhirët për vendasin ishin një barrë shumë e rëndë për shkak se vetë banorët ishin ata të cilët ballafaqoheshin me këtë popullatë të pa strehë, pa ushqime dhe me sëmundje të ndryshme. Banorët ndanin tokën e tyre për familjet muhaxhire, edhe pse më herët vendasit ishin detyruar që një pjesë të tokës t’ia jepnin zotërisë për arsye të ndryshme.<sup>2</sup> Pastaj, toka e fshatarëve iu ndahej muhaxhirëve nga zotëria, ndërsa toka me re tërësisht iu dhurua muhaxhirëve, kështu popullatës vendase i zvogëlohej toka që shfrytëzohej edhe për kullosa dhe kjo bënte që mes tyre të kishte edhe konflikte rreth një copë toke. Për këto shkaqe shumë nga banorët vendas dhe muhaxhir detyroheshin të dilnin në male dhe t’iu zinin prita të pasurve, që në atë kohë këtë status e mbanin njerëz të Pushtetit Osman, të cilët edhe i konsideronin si fajtorë për gjendjen e krijuar.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Avdyli, Merxhan, and Veli Kryeziu. "Historical, cultural and musical analysis of folk songs about the Çanakkale battle in Albanian music folklore: Albanian teachers' opinions." *Rast Muzikoloji Dergisi* 10, no. 2 (2022): 289-309. Cfr. Brestovci, Meliha, and Arsim Sinani. "Comparative analysis of English prepositions in and on translated into Albanian." *Journal of Language Teaching and Research* 13, no. 3 (2022): 462-470.

<sup>2</sup> Sinani, Arsim, and Veli Kryeziu. "Yugoslav Totalitarian Society, Discrimination Against Albanian and Bulgarian Minorities in Macedonia." *Балканистичен Форум*, 32/2023, Nr. 3, pp. 167-185.

<sup>3</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 84-85.



*Fig. 1. Harta me fshatrat e Gallapit të Prishtinës<sup>1</sup>*

### **Familjet muhaxhire të vendosura në Gallapin e Prishtinës**

- Bagjurët, nga fshati Bagjur (Qarku i Toplicës),
- Brainët, nga Braina e Madhe, (Rrethina e Medvegjës),
- Bellopojët, nga fshati Bellopojë e Toplicës, Ali. Sh. Berisha,
- Berjanët, nga fshati Berjan (Pusta Rekë),
- Bërbatovcët, nga fshati Bërbatovc (rrethina e Bllacës),
- Bllacakët, nga fshati Bllacë (Rrethi i Prokuplës),
- Boshnjakët, nga fshati Toçan, Lugina e Toplicës,
- Braishorët; nga fshati Brajshor (Rrethi i Prokuplës),
- Bublakët, nga Fshati Bubicë (Rrethi i Prokuplës),
- Bucollët, nga Fshati Bucë, (Rrethi i Leskovcit),<sup>2</sup>
- Bunjakët, nga Fshati Bunjak (Rrethi i Kosanicës),
- Bogunovcët, nga Fshati Bogunovcë (Komuna e Medvegjës),
- Borocët, nga Fshati Borovc (Rrethi i Medvegjës),
- Byçmetët, nga Fshati Byqmet i Mesëm (Rrethina e Medvegjës),
- Buvçët, nga fshati Buvçë (Komuna e Lebanës, Rrethi i Jabllanicës),
- Cërvadikët, nga Fshati Cervadik (Rrethi i Jabllanicës),
- Cërnavërnët, nga Fshati Cernovern (Rrethi e Medvegjës, Rrethi i Jabllanicës),
- Çokotonët (Çokotët), nga Fshati Çokotin (Rrethi i Medvegjës),<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Harta kadastrale e Kosovës, Drejtoria e Gjeodezisë në Prishtinë, përpunoi Enti për Kartografi "Geokarta", (Beograd: 1980).

<sup>2</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 84-85.

<sup>3</sup> Karta JNA, Prishtina 2 nr. 31/2 (poverlijiivo broj evidencije)

- Dankët (Kelani), nga Fshati Dankë (Rrethi i Kushumlisë),
- Dedincët, nga Fshati Dedincë (Rrethi e Kushumlisë),
- Dediqët, Nga Fshati Dediq (Rrethi i Jabllanicës)
- Dërvodelët, nga Fshati Dërvodel (Rrethi i Lebanës),
- Deshishkët, nga Fshati Deshishk (Rrethi i Kushumlisë),
- Dragushët, nga Fshati Dragushë (Rrethi i Bllacës),
- Dobratiqët, nga Fshati Dobratiq (Rrethi i Prokoplës),
- Dobratinët, nga Fshati Dobratin (Qarku i Toplicës),
- Dragidellët, nga Fshati Dragidell (Rrethi i Prokoplës),
- Doshlakët, nga Fshati Doshlak (afër Ivan Kulles, Rrethi i Prokuples),
- Dubovcët, nga Fshati Dubovë (Rrethi i Zhitgjës),
- Errmokët, nga Sanxhaku i Nishit, sipas Ali Sh. Berisha,
- Gubetinët, nga Fshati Gubetin (Qarku i Toplicës, Rrethi i Dobriqit),
- Gajtanët, nga Fshati Gajtan i Epërm (Rrethi i Medvegjës),
- Gosalcët, nga Fshati Negosavle (Rrethi i e Medvegjës)<sup>1</sup>,
- *Govorët, nga Fshati Govor (Toplicë).*<sup>2</sup>,
- Gozdarët, nga Fshati Gazdarë (Rrethi i Medvegjës),
- Gjakët, nga Fshati Xhakë (Rrethi i Kushumlisë),
- Gjylekarët, nga Fshati Gjulekar (Rrethi i Medvegjës),
- Gjyshincët, nga Fshati Gjushincë (Rrethi i Prokoplës),
- Hashanët, nga Fshati Hashonoc (Rrethi i Zhitoragjës),
- Huruglicët, nga Fshati Huruglicë e Poshtme (Rrethi i Leskovcit),
- Jashanicët, nga Fshati Jashanicë e Epërme (Rrethi i Bllacës),
- Kapitët, nga Fshati Kapit (Rrethi i Medvegjës),
- Karrafetët, nga Fshati Karanoc (Janë nga Kraleva që është quajtur Karanovc),
- Klaiqët, nga Fshati Klaiq (Rrethi i Lebanës),
- Kollaqët, nga Fshati Kullaq (Rrethi i Jabllanicës),
- Konjufcët, nga Fshati Konjufca e Poshtme (Rrethi i Bojnikut),
- Konjushët, nga Fshati Konjushë (Rrethi i Prokoplës),
- Kopranët, nga Fshati Kopran (Rrethi i Jabllanicës),
- Krivodërvët, nga Fshati Krivodërvë (Rrethi i Jabllanicës),
- Kuqët, nga Fshati Kuq (Rrethi i Kosanicës),
- Kutleshët, nga Fshati Kutlesh (Rrethi i Leskovcit),
- Kutllofcët, nga Fshati Kutllovc i Madh (Rrethi i Bllacës),
- Leposhtakët, nga Fshati Leposhticë (Rrethi i Jabllanicës). Sipas Ali Sh. Beirsha, familja Leposhtica vjen nga Rrethi i Vranjes,

<sup>1</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 84-85.

<sup>2</sup> *Sabit Uka "Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në KOSOVE", libri 2, Pjesa e parë, Prishtinë 1994, f.230-231.*

- Lipovicët, nga Fshati LIPOVICË (Rrethi i Leskocit),
- Llumnicët, nga Fshati Llumnicë (Rrethi i Kosanicës),
- Llapashticët; nga Fshati Llapashtica e Poshtme (Rrethi i Medvegjës),
- Malokët, Malokë, (nga Toplica). Nuk dihet se nga cili fshat,
- Makollët, nga Fshati Retkocer i Poshtëm (Rrethi i Medvegjës),
- Medecët, nga Fshati Medvec (Rrethi i Medvegjës),
- Mërkonjë, nga Fshati Mërkonjë (Rrethi i Medvegjës),
- Mojkocët; nga Fshati Majkoc (Rrethi i Bojnikut),
- Matarovët, nga Fshati Matarovë (Rrethi i Kushumlisë),
- Maqedoncët, nga Fshati Maqedonc (Rrethi i Medvegjës),
- Maqastenët, nga Fshati Maqastenë (Rrethi i Kushumlisë),
- Mardoçët, nga Fshati Mardoq (të ardhur nga Perpori afër Brainës),
- Mehanët, nga Fshati Mehanë (Rrethi i Kushumlisë),
- Miskiqët, nga Fshati Miskiq (Rrethi i Jabllanicës),
- Mlladoshevcët, nga Fshati Mlladeshevc (Qarku i Toplicës),
- Mollkuqët, nga Fshati Molliq (Rrethi i Prokupljes, të ardhur nga Pllana e Madhe),
- Mramorët, nga Fshati Mramor (Rrethi i Meroshinës),
- Mulakët, nga Fshati Muleviq (Rrethi i Kosanicës),
- Masuricët, nga Fshati Masuricë (Rrethina e Surdulicës),
- Pestishët, nga Fshati Pestish (Rrethi i Prokuplës),
- Përporët, nga Fshati Përporë (Rrethi i Jabllanicës),
- Pllanalitë, nga Fshati Pllana e Madhe (Rrethi i Prokuplës),
- Prebrezët, nga Fshati Prebreza e Epërme (Rrethi i Bllacës),
- Prekorogjë, nga Fshati Prekorogjë (Rrethi i Kushumlisë),
- Prekupët, nga Fshati Prekopucë (Rrethi i Prokuplës),
- Podvoricët, nga Fshati Pridvoricë (Rrethi i Bllacës),
- Poroshticët, nga Fshati Poroshticë (Rrethi i Medvegjës),
- Qyqallët, nga Fshati Qyqallë (Rrethi i Bllacës),
- Oranët, nga Fshati Oranë (Rrethi i Bojnikut),
- Raçët, nga Fshati Raçë (Rrethi i Kushumlisë),
- Radeçët, nga Fshati Radovcë (Rrethi i Jabllanicës),
- Rafunët, nga Fshati Rafunë (Rrethi i Lebanës - Rrethi i Jabllanicës),
- Ramabajët, nga Fshati Ramabajë (Rrethi i Medvegjës),
- Ramadenët, nga fshati Ramnidell (Rrethi i Leskofcit),
- Reçicët, nga Fshati Reçicë (Rrethi i Prokuplës),
- Radinocët, nga fshati Radinovc (Rrethi i Lebanës),
- Rekalitë, nga Fshati Ravna Reka (Rrethi i Polanicës),
- Ratkocerët, nga Fshati Retkoceri i Poshtëm (Rrethi i Medvegjës),
- Rukocët, nga Fshati Rukoc (Rrethi i Medvegjës),

- Rudarët, nga fshati Rudar (Rrethi i Kushumlisë),
- Sallahët, nga Banja e Siarinës (Medvegjë),
- Sekiraçët, nga Fshati Sekiraqë (Rrethi i Kushumlisë),
- Sfircaçët, nga Fshati Sfirçë (Rrethi i Medvegjes),
- Sfarçët, nga Fshati Sfarçë e Poshtme (Rrethi i Bllacës),
- Sijarinët, nga Fshati Sijarinë (Rrethi i Medvegjës),
- Simnicët, nga Toplica, (Rrethi i Bllacës), sipas Ali Sh. Berisha,
- Slishanët, nga Fshati Slishan (Rrethi i Lebanës),
- Slivovët, nga Fshati Slivovë (Rrethi i Prokuplës),
- Statofcët, nga Fshati Statovci i Epërm (Rrethina e Prokuplës),
- Spancët, nga Fshati Spancë (Rrethi i Medvegjës),
- Stubulakët, nga Fshati Stubull (Rrethi i Medvegjës),
- Starabajtë, nga Fshati Starabajë (Rrethi i Medvegjës),
- Shushnjakët, nga Fshati Shushnjak (Rrethi i Prokuplës),
- Surdullët, nga Fshati Surdulicë (Sot komunë),
- Sfinjishtët, nga Fshati Sfinjishtë (Rrethi i Kushumlisë),
- Shillovët, nga Fshati Shillovë (Rrethi i Lebanës - Rrethi i Jabllanicës),
- Shpatollët, (Rrethi i Medvegjes),<sup>1</sup> sipas Ali Sh. Berisha,
- Talirët, (Rrethi i Medvegjës), mendohet nga Vrapca,
- Tërhollet, nga Fshati Tërth (Qarku i Toplicës),
- Tërmmkollët, nga Fshati Tërmmkë (Rrethi i Kushumlisë),
- Tërbunjët, nga Fshati Tërbujë e Poshtme (Rrethi i Bllacës),
- Tërstenët, nga Fshati Terrstena (Rrethi i Vranjës),
- Tërskali: Tërshka Arbanishta<sup>2</sup> (e shënon dr. Sabit Uka),
- Tërpezët, nga Fshati Tërpezë (Rrethi i Kushumlisë),
- Toçanët, nga Fshati Toçani i Epërm (Rrethi i Kushumlisë),
- Torët, nga Fshati Torë (Rrethi i Prokuplës),
- Tullarët, nga Fshati Tullar (Rrethi i Medvegjës),
- Tupallët, nga Fshati Tupallë (Rrethi i Medvegjës),
- Vllahitë, nga Fshati Vllahi (Qarku i Toplicës),
- Villasët, nga Fshati Villasë (Rrethi i Leskofcit),
- Vranocët, nga Fshati Vranoc (Qarku i Toplicës),
- Vrapcët, nga Fshati Vrapcë (Rrethi i Medvegjës),
- Vrellakët, nga Fshati Vrellë (Qarku i Nishit),
- Vujanovët, nga Fshati Vujanovë (Rrethi i Jabllanicës),
- Zagragjët, nga Fshati Zagragjë (Rrethi i Kushumlisë),

<sup>1</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 84-221

<sup>2</sup> Sabit Uka "Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në KOSOVË", libri 2, Pjesa e parë, Prishtinë 1994, f.230-231.

- Zebicët, nga Fshati Zebicë (Rrethi i Kushumlisë),
- Zllatët, nga Fshati Zllat (Rrethi i Prokuplës,
- Zhininipotokët, nga Fshati Zhitni Potok (Rrethi i Prokuplës),
- Zullufët, nga Fshati Retkocer i Poshtëm (Rrethi i Medvegjës),
- Zhugollët, nga fshati Zhugoll (Rrethi i Vranjës),
- Zhujanët, nga Fshati Zhujë (Rrethi i Medvegjës) sipas Ali Sh. Berisha,<sup>1</sup>
- Zhushët, nga fshati ZHUSH (RESINCA, qarku i Toplicës).<sup>2</sup>

### **Vendosja e popullatës muhaxhire në Gallapin e Prishtinës**

Popullata e vendosur në Gallapin e Prishtinës ishte e përbërë kryesisht nga familje të ndara nga grupi i familjeve të tëra dhe kompakte, siç janë fshatra të tëra në Fushë – Kosovë. Këto familje në shumë vende është e lehtë të deshifrohen për shkak se me vete sollën edhe emrin e fshatit nga vinin.<sup>3</sup>

**Në fshatin Batllavë u vendosën:** Boshnjakët: 2 familje, Kutllofcët: 2 familje, Malokët: 1 familje, Mehanët: 1 familje, Prekorogjë: 2 familje, Ratkocerët: 1 familje, Rukofcët: rreth 2 familje, Shillovët, 1 familje, Statovcët: 5 familje.

**Në fshatin Ballaban u vendosën:** Cërvadikët: 1familje, Mlladoshevcët: 1familje, Kapitët: 3 familje, Kopranët: 1 familje, Maqedoncët: 1 familje, Prekorogjët: 3 familje, Rotkocerët: 1 familje, Sfirçakët: 1 familje, Shillovët: 1 familje, Tërmkollët: 1 familje, Vranocët: 1 familje,

**Në fshatinë Barainë:** u vendosën: Bublakët, 1 familje; Dobratinë: 1 familje; Gjaka: 1 familje; Rukofcët: 1 familje; Ratkocerët: 1 familje; Slisihanët: 1 familje; Tërpezët: 1 familje; Torët: 1 familje.

**Në fshatin Bellopojë u vendosën:** Deshishkët: 3 familje, Govorët: 8 familje, Llumnicët: 7 familje, Malokët: 8 familje, Matarovët: 2 familje, Raçë: 1 familje, Rukovicët: 1 familje, Rudarët: 2 familje, Sfarçët: 1 familje, Tërbunjët: 8 familje, Vllasët: 2 familje.

**Në fshatin Besi vendosen:** Bllacakë: 2 familje,<sup>4</sup> Dragushë: 1 familje,<sup>5</sup> Prebrezë: 1 familje, Qyqallë: 1 familje, Tërmkollë: 1 familje.<sup>6</sup>

**Në fshatin Bërvenik u vendosën:** Brainë: 2 familje, Gjaka: 1 familje, Përpollë: 3 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sekiraçë: 2 familje, Shillovë: 1 familje, Tullar: 1 familje

<sup>1</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 84-221

<sup>2</sup> Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Katalog i Ekspozitës, Dëbimi i Shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78, (Prishtinë: 2018). 14-26.

<sup>3</sup> Sinani, Arsim, and Rrezehana Hysa. "Mehmet Pashë Deralla, kalorësi i pamposhtur i Shqipërisë." *Diskutime* 7, no. 23 (2018): 140-163.

<sup>4</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 184- 209

<sup>5</sup> Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878. (Prishtinë: 1994). 153

<sup>6</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 209

**Në fshatin Brainë:** Çokatonë: 1 familje, Cërnavërnë: 1 familje, Dragidellë: 2 familje, Gjylekar: 2 familje, Mardoçë: 3 familje, Malokë: 1 familje, Medecë, 2 familje, Mërkonjë: 1 familje, Mollkuq: 2 familje, Prokupë: 1 familje, Ramabajë: 2 familje, Ratkocerë: 2 familje, Sekiraçë: 2 familje, Statofcë: 1 familje, Svinjishtë: 1 familje, Tërpezë: 2 familje, Tullarë: 1 familje, Zhujanë: 1 familje,<sup>1</sup>

**Në fshatin Berrnica e Epërme:** Bagjurë: 1 familje, Braishorë: 1 familje, Dankë (Kelan): 1 familje, Dobratiq: 1 familje, Gjyshincë: 1 familje, Jashanicë: 20 familje, Pestishë: 1 familje, Rekalitë: 1 familje, Simnicë: 1 familje, Svinishtë: 1 familje, Toçanët: 1 familje,

**Në fshatin Butoc u vendosën:** Cërnavërh: 2 familje, Dedincë: 3 familje, Gosalcë: 1 familje, Kopranë: 1 familje, Maqedoncë: 1 familje, Mulakë: 1 familje, Reçicë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sijarinë: 1 familje, Gajtan (Sop): 1 familje, Statofcë: 1 familje, Svinishtë : 2 familje, Tërskali: 1 familje, Tupallë: 2 familje, Vujanovë: 5 familje,

**Në fshatin Busi vendosën:** Byçmetë: 1 familje, Kollaçë: 1 familje, Sfarçë: 1 familje, Shpatollë: 1 familje, Tullarë: 1 familje,

**Në fshatin Dabishevc u vendosën:** Borocë: 3 familje, Kopranë: 1 familje, Mramor: 1 familje, Radinocë: 1 familje, Ramadenë: 3 familje, Sekiraçë: 1 familje, Sijarinë: 1 familje, Svircakë: 1 familje, Vrapcë: 1 familje, Zhugollë: 1 familje,

**Në fshatin Dyzë u vendosën:** Bllacakë: 3 familje, Cërnavërh: 1 familje, Llapashticë: 1 familje, Mehanë: 1 familje, Majkocë: 1 familje, Rafunë: 2 familje, Ratkocerë: 1 shtëpi, Stubullakë: 1 familje, Tërhollë: 1 familje, Vllasë: 1 shtëpi,

**Në fshatin Lebanë u vendosën:** Bellopojë: 1 familje, Bërbatovcë: 1 familje, Dobratiqë: 2 familje, Prebrezë: 1 familje, Shushnjakë: 1 familje,

**Në fshatin Llabjan u vendosën:** Bogunovcë: 1 familje, Dragidellë: 2 familje, Slishanë: 1 familje, Vllasë: 1 familje,

**Në fshatin Llukar u vendosën:** Dubovcë: 1 fajmilje,

**Në fshatin Grashticë u vendosën:** Berjanët: 1 familje, Cëravadikë: 3 familje,<sup>2</sup> Kopranë: 1 familje, Oranë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Spancë: 1 familje, Stubullakë: 1 familje, Shillovë: 1 familje,<sup>3</sup>

**Në fshatin Gërdoc u vendosën:** Govorët: 3 familje, Raçë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje,

<sup>1</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 87-90

<sup>2</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë, 2009). 160-160

<sup>3</sup> Sabit Uka, Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë (1878-1912).Instituti Albanologjik, (Prishtinë, 1994). 204

**Në fshatin Gllugovicë vnedosën:** Cërnavërh: 1 familje, Mërkonjë: 1 familje, Sallahë: 5 familje, <sup>1</sup> Svirçakë: 1 familje,<sup>2</sup> Vranovcë: 1 familje, Vrapcë: 1 familje,<sup>3</sup>

**Në Graçanicë u vendosën:** Sfirçakë: 7 familje,

**Në fshatin Halabak u vendosën:** Gubetinët: 3 familje, Llumnicë: 1 familje, Maqastënë: 1 familje, Pllanë: 1 familje, Prekorogjë: 1 familje, Raçë: 1 familje, Rafunë: 1 familje, Rukovcë: 1 familje, Stubullakë: 1 familje,<sup>4</sup>

**Në fshatin Hajkobillë:** Borovcë: 1 familje, Byçmetë: 2 familje, Dërvodelë: 1 familje, Gjylekarë: 1 familje, Klaiqë: 1 familje, Llapashticë: 1 familje, Lipovicë: 1 familje, Mërkojë: 1 familje, Masuricë: 1 familje, Tërstenë: 2 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sijarinë: 2 familje, Talirë: 2 familje,<sup>5</sup>.

**Në fshatin Hajvali u vendosën:** Bagjurë: 1 familje, Bucollë: 1 familje, Byçmetë: 1 familje, Doshlakë: 1 familje, Dragidellë: 1 familje, Gjaka: 2 familje, Huruglicë: 1 familje, Kollaqë: 1 familje, Kuqë: 1 familje, Leposhtakë: 1 familje, Lipovicë: 1 familje, Llapashticë: 1 familje, Malokë: 1 familje, Mehanë: 2 familje, Mërkonjë: 1 familje, Miskiçë: 1 familje, Pllanali: 2 familje, Prekopucë: 3 familje, Poroshticë: 1 familje, Rakovicë: 1 familje, Rafunë: 1 familje, Ramabajë: 1 familje, Sijarinë: 1 familje, Slishanë, 1 familje, Statofcë: 4 familje, Sfinjishtë: 3 familje, Tërhëhollë: 2 familje, Tullarë: 3 familje, Tupallë: 1 familje, Vrapcë: 1 familje, Zhinipotokë: 2 familje.

**Në fshatin Kalatic:** Dragidellë: 1 familje, Mardoqë: 1 familje, Mollëkuq: 2 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sekiraçë: 2 familje, Statofcë: 1 familje, Shillovë: 1 familje, Terpezë: 2 familje,<sup>6</sup>

**Në fshatin Keqekollë vendosen:** Cërvadikë: 13 familje, Errmokë: 1 familje, Mërkojë: 8 familje, Govorë: 5 familje, Gajtanë: 1 familje, Kopranë: 2 familje, Maqastënë: 11 familje, Oranë: 3 familje,<sup>7</sup> Ratkocerë: 1 familje,<sup>8</sup> Slivovë: 1 familje, Tërpezë: 1 familje,<sup>9</sup> Zagragjë: 3 familje,<sup>10</sup>

<sup>1</sup> Emin Sallahu, Intervisitë personale. 24.02.2021

<sup>2</sup> Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878. (Prishtinë:1994). 156

<sup>3</sup> Jakup Demollit, 76 vjeçar i intervistuar nga Ali Sh. Berisha në vitin 2005.

<sup>4</sup>Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 196

<sup>5</sup> Azem Taliri, Intervistë me telefon – messenger. Prishtinë, 28.02.2021

<sup>6</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 127

<sup>7</sup> Arben Berisha, “Muhaxhirët në Gallapin e Prishtinës”, Temë diplome, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofike 2005.

<sup>8</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë, 2009). 130-131

<sup>9</sup> Arben Berisha, “Muhaxhirët në Gallapin e Prishtinës”, Temë diplome, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofike 2005.

<sup>10</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 130-131

**Në fshatin Koliq u vendosën:** Kapitë: 2 familje,<sup>1</sup> Maqedoncë: 1 familje, Makollë: 1 familje,<sup>2</sup> Mërkonjë: 1 familje, Rukovcë: 1 familje, Tërhollë: 2 familje, Tullarë: 1 familje,<sup>3</sup> Sekiraçë: 1 familje, Statofcë: 1 familje, Zullufë: 1 familje,

**Në fshatin Kukavicë u vendosën:** Miskiçë: 4 familje, Ratkocerë: 1 familje,

**Në fshatin Kushevicë u vendosën:** Gjaka: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sekiraçë: 1 familje, Shillovë: 1 familje,

**Në fshatin Marec u vendosën:** Borocë: 1 familje, Bublak: 1 familje, Gosalcë: 3 familje, Llapashticë: 1 familje, Leposhtakë: 1 familje, Poroshtincë: 1 familje, Ramabanjë: 1 familje, Rafunë: 1 familje, Sijarinë: 1 familje, Starabajë: 2 familje,

**Në fshatin Matičan u vendosën:** Borovcë: 5 familje, Bunjakë: 2 familje, Dërvodelë: 1 familje, Dushollovcë: 2 familje, Llapashticë: 1 familje, Llumnice: 1 familje, Poroshticë: 10 familje, Radecë: 1 familje, Rafunë: 8 familje, Ramabajë: 3 familje, Rukovcë: 1 familje, Surdullë: 7 familje,

**Në fshatin Makoc u vendosën:** Kopranë: 1 familje, Maqedoncë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Tupallë, 1 familje,

**Në fshatin Milevc u vendosën:** Dedincë: 1 familje, Pllanë: 1 familje, Zhushë: 1 familje,<sup>4</sup> 3 familje me gjithsej 21 antarë

**Në fshatin Mramor u vendosën:** Sipas Dr. Sabit Ukës, familjen **Stullçaku** e vendos si muhaxhire të ardhur nga Stullçi i Pustarekës.<sup>5</sup> Sipas të dhënave të kryefamiljarit të familjes Stullçaku, z. Ramush Gashi, kuptohet se familja e tij, që kishte rënë në gjak në fshatin Mramur, dërgohet në vuajtje dënimi në Stullç. Me kalimin e afatit të dënimit kthehen në Mramur, por jo në vendin ku ishin më parë. Pleqtë e Mramurit i vendosin në kufi me Grashticën. Gajtanë (sop): 1 familje, Sfarçë: 1 familje, Smunicë: 3 familje

**Në fshatin Mukatë u vendosën:**

Slisbanë: 1 familje, Sijarinë: 1 familje, Svarçë: 5 familje, Tullarë: 3 familje,

**Në fshatin Nishec u vendosën:** Buvcë: 1 familje, Dediçë: 1 familje, Konjufcë: 1 familje, Prekorogjë: 1 familje, Rafunë: 1 familje, Radecë: 1 familje, Sekiraçë: 1 familje, Svirçë: 1 familje, Tërhollë: 1 familje, Tërpezë: 1 familje, Tullarë: 1 familje,

**Në fshatin Senidoll u vendosën:** Mërkonjë: 1 familje, Pestishë: 1 familje, Toçanë: 1 familje,

**Në fshatin Sofali u vendosën:** Konjushë: 1 familje, Lipovicë: 3 familje, Sfarçë: 1 familje, Shillovë: 1 familje,

<sup>1</sup> Sabit Uka, *Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë (1878-1912)* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994). 213.

<sup>2</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 138-139

<sup>3</sup> Sabit Uka, *Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë (1878-1912)* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994). 213.

<sup>4</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 138-215

<sup>5</sup> Sabit Uka, *Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë (1878-1912)* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994). 224..

**Në fshatin Shakovicë u vendosën:** Kapitë: 1 familje, Miskiçë: 1 familje, 2 familje me gjithsejt 14 anëtarë,

**Në fshatin Siqevë u vendosën:** Pllanë: 1 familje, Sfinjishtë: 1 familje, Sfircajë: 1 familje,<sup>1</sup>

**Në fshatin Sharban u vendosën:** Brajshorë: 2 familje, Maqedoncë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sfinjishtë: 1 familje, Sekiraçë: 1 familje, (6 familje me gjithsej 42)

**Në fshatin Orllan u vendosën:** Cërvadikë: 1 familje, Gajtanë: 1 familje, Gozdarët: 1 familje, Hashanë: 1 familje, Kutleshë: 1 familje, Mehanë: 1 familje, Maqedoncë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sekiraçë: 1 familje, Spancë: 1 familje, Statofcë: 1 familje, Sijarinë: 1 familje, Shillovë: 1 familje,

**Në fshatin Prapashticë u vendosën:** Bucoll: 1 familje, Bublakë: 1 familje, Gajtanë: 1 familje, Govorë: 1 familje, Gjaka: 1 familje, Sekiraçë: 1 familje, Sijarinë: 2 familje, Vrapcë: 1 familje,

**Në fshatin Radashec u vendosën:** Braishorë: 1 familje, Prekorogjë: 1 familje, Svirçë:1 familje, Spancë: 1 familje, Svinjishtë: 1 familje,

**Në fshatin Rimanishtë u vendosën:** Gubetinë: 2 familje, Karrafetë: 1 familje, Rudarë: 1 familje, Tërbunjë: 1 familje, Tërpezë: 1 familje, Zebincë: 1 familje, (7 familje me gjithsej 49 anëtarë).

**Në fshatin Teneshdoll u vendosën:** Prebrezë: 1 familje, Vllasë: 1 familje, Vrellakë: 1 familje,

**Në fshatin Terrnavë u vendosën:** Gjaka: 1 familje, Mehani: 1 familje, Podvoricë: 2 familje, Prebrezë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Sekiraçë: 1 familje, Statofcë: 1 familje, Tullarë: 1 familje, Vllahi: 4 familje, Vllasë: 3 familje, Zagragjët: 1 familje, Zhinipotokë: 3 familje,

**Në fshatin Trudë u vendosën:** Dëshishkë: 1 familje, Dobratiqë: 1 familje, Dankë (Kelan): 1 familje, Shushnjakë: 1 familje,

**Në fshatin Vranidoll u vendosën:** Jashanicë: 1 familje, Dankë - Kelanë: 2 familje, Prebrezë: 1 familje, Reçicë: 2 familje, Vrellakë: 1 familje, Zhushë: 2 familje,

**Në fshatin Zllatar u vendosën:** Borovcë: 3 familje, Rafunë: 1 familje, Sijarinë: 2 familje, Shillovë: 7 familje, Tullarë: 2 familje, Zllatë: 3 familje,

**Në Zllash u vendosën:** Gajtanë: 1 familje, Dragidellë: 1 familje, Krilevë: 1 familje, Krivodërvë: 1 familje, Lipovicë: 1 familje, Prekorogjë: 1 familje, Ramadenë: 1 familje, Ratkocerë: 1 familje, Slishanë: 1 familje, Svarçë: 1 familje, Tupallë: 1 familje, Zagragjët: 1 familje,<sup>2</sup>

**Numri i familjeve dhe anëtareve të vendosur në Gallap të Prishtinës**

<sup>1</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 159-220

<sup>2</sup> Ali Sh. Berisha, Gallapi i Prishtinës II (1980-1912) (Prishtinë: 2009). 99-260

Nga 48 fshatra të përfshira në këtë punim, kemi arritur të përfitojmë edhe numrin e përafërt të familjeve dhe anëtareve të vendosura nëpër secilin fshat. Po llogaritëm edhe numrin total të familjeve dhe numrit të anëtarë vendosur në Gallap, do të kuptojmë se në cilin fshat ka më së shumti të vendosur familje muhaxhire.

Llogaritja është bërë duke shumëzuar numrin e familjeve me 7 (anëtarë). Nga llogaritja e më poshtme numërojmë 552 familje me gjithsej 3981 anëtarë.

Llukar, 2 familje, gjithsej 14 anëtarë; Milevc, 3 familje, gjithsej 21 anëtarë; Senidoll, 3 familje, gjithsej 21 anëtarë; Shakovicë, 3 familje, gjithsej 21 anëtarë; Teneshdoll, 3 familje, gjithsej 21 anëtarë; Kukavicë, 4 familje, gjithsej 28 anëtarë; Makoc, 4 familje, gjithsej 28 anëtarë; Trudë, 4 familje, gjithsej 28 anëtarë; Busi, 5 familje, gjithsej 35 anëtarë; Llabjan, 5 familje, gjithsej 35 anëtarë; Gërdoc, 5 familje, gjithsej 35 anëtarë; Mramuer, 5 familje, gjithsej 35 anëtarë; Radashec, 5 familje, gjithsej 35 anëtarë; Besi, 6 familje, gjithsej 42 anëtarë; Lebanë, 6 familje, gjithsej 42 anëtarë; Sofali, 6 familje, gjithsej 42 anëtarë; Sharban, 6 familje, gjithsej 42 anëtarë; Graçanicë, 7 familje, gjithsej 49 anëtarë; Rimanishtë, 7 familje, gjithsej 49 anëtarë; Barainë, 8 ;familje, gjithsej 56 anëtarë; Prapashticë, 9 familje, gjithsej 63 anëtarë; Vranidoll, 9 familje, gjithsej 63 anëtarë; Grashticë, 10 familje, gjithsej 70 anëtarë; Glllogovicë, 10 familje, gjithsej 70 anëtarë; Halabak, 10 familje, gjithsej 70 anëtarë; Mukatë, 10 familje, gjithsej 70 anëtarë; Bërvenik, 11 familje, gjithsej 77 anëtarë; Kalatic, 11 familje, gjithsej 77 anëtarë; Nishec, 11 familje, gjithsej 77 anëtarë; Koliq, 12 familje, gjithsej 84 anëtarë; Zllash, 12 familje, gjithsej 84 anëtarë; Dyz, 13 familje, gjithsej 91 anëtarë; Marec, 13 familje, gjithsej 91 anëtarë; Orllan, 13 familje, gjithsej 91 anëtarë; Dabishevc, 14 familje, gjithsej 98 anëtarë; Ballaban, 15 familje, gjithsej 105 anëtarë; Batllavë, 17 familje, gjithsej 119 anëtarë; Hajkobillë, 17 familje, gjithsej 119 anëtarë; Zllatar, 18 familje, gjithsej 126 anëtarë; Terrnavë, 20 familje, gjithsej 140 anëtarë; Butoc, 23 familje, gjithsej 161 anëtarë; Brainë, 28 familje, gjithsej 196 anëtarë; Berrnica e Epërme, 30 familje, gjithsej 201 anëtarë; Matiçan, 42 familje, gjithsej 294 anëtarë; Bellopojë, 43 familje, gjithsej 301 anëtarë; Hajvali, 45 familje, gjithsej 315 anëtarë; Keqekollë, 50 familje, gjithsej 350 anëtarë.

### **Emërtimet e familjeve muhaxhirë të vendosura në Gallapin e Prishtinës dhe numri i familjeve të vendosura në këtë trevë**

Me nga 1 familje na paraqiten: Bellopojët, Berjanët, Bërbatovcët, Bunjakët, Bogunovcët, Buvcët, Çokotonët (Çokotët), Dediqët Dragushët, Dobratinët, Doshlakët, Dubovcët, Errmokët, Gozdarët, Gjyshincët, Hashanët, Huruglicët, Klaiqët, Konjufcët, Konjushët, Karrafetët, Krivodërvët, Kuqët, Kutleshët, Makollët, Mojkovcët, Maqastenët, Mlladoshevcët, Mramort, Masuricët, Qyqallët, Radinocët, Rekalitë, Simnicët, Slivovët, Shpatollët, Torët, Zebicët, Zullufët, Zhugollët, Zhujanët; Me nga 2 familje: Bagjurët, Boshnjakët, Braishorët, Bublakët, Brainët, Bucollët, Dërvodelët, Gjylekarët, Kollaqët, Kutllofcët, Leposhtakët, Medecët, Mulakët,

Pestishët, Matarovët, Podvoricët , Radecët, Starabajtë, Shushnjakët, Talirët, Tërstenët, Toçanët, Tupallët, Vranocët, Vrellakët, Tërmkollët;  
 Me nga 3 familje: Përporët, Prekupët, Raçët, Reçicët, Spancët, Stubulakët, Rudarët, Zllatët, Zhushët. Me nga 4 familje na paraqiten: Byçmetët, Dankët (Kelani), Dedincët, Dëshishkët, Dobratiqët, Gosalcët , Maqedoncët, Mardoçët, Mollkuqët, Oranët, Ramadenët, Sfarçët, Vllahitë, Vrapcët, Me nga 5 familje: Cërnavërnët, Gubetinët, Gjakët, Lipovicët, Lllapashticët, Pllanalitë (Pllanët), Prebrezët, Sallahët, Sfinjishtët, Slishanët, Tërpezët, Tërskalitë, Vujanovët, Zagragjë, Zhininipotokët. Me nga 6 familje: Gajtanët, Kapitët, Mehanët, Miskiqët, Tërhollët, Bllacakët, Dragidellët, Kopranët, Prekorogjë, Ramabajët, Surdullët. Me nga 8 familje janë: Rukofcët, Vllasët. Ndërsa me 9 familje paraqiten: Llumnice, Sfirca, Tërbunjë. Me 11 familje: Malokët. 12 Familje: Poroshticët, Sijarinët. 13 familje:, Borocët. 14 familje: Mërkonjë, Sekiraçët, Tullarët. 15 Familje: Rafunët , Statofcët, Shillovët. 17 Familje janë: Govorët. Me 18 familje: Cërvadikët. Me 20 familje vijnë Ratkocerët. Ndërsa Jashanicët na paraqiten si familja më e madhe muhaxhire e vendosur në Gallap me gjithsej 21 familje.

#### Literatura:

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Katalog i Ekspozitës, Dëbimi i Shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877/78*. Prishtinë: 2018.

Avdyli, Merxhan, and Veli Kryeziu. "Historical, cultural and musical analysis of folk songs about the Çanakkale battle in Albanian music folklore: Albanian teachers' opinions." *Rast Muzikoloji Dergisi* 10, no. 2 (2022): 289-309. [10.12975/rastmd.20221028](https://doi.org/10.12975/rastmd.20221028)

Berisha, Arben, "Muhaxhirët në Gallapin e Prishtinës", Temë diplome. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, 2005.

Berisha, Ali Sh, *Gallapi i Prishtinës II (1980-1912)*. Prishtinë: 2009.

Brestovci, Meliha, and Arsim Sinani. "Comparative analysis of English prepositions in and on translated into Albanian." *Journal of Language Teaching and Research* 13, no. 3 (2022): 462-470. <https://doi.org/10.17507/jltr.1303.02>

Uka, Sabit, *Vendosja dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë (1878-1912)*. Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994.

Uka, Sabit. *Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit (1877-1878)*. Prishtinë:1994.

Harta Kadastrale e Kosovës, Drejtoria e Gjeodezisë në Prishtinë, përpunoi Enti për Kartografi "Geokarta", Beograd: 1980.

Sallahu Emin, Intervistë personale. 24.02.2021

Sinani, Arsim, and Veli Kryeziu. "Yugoslav Totalitarian Society, Discrimination Against Albanian and Bulgarian Minorities in Macedonia." *Балканистичен Форум*, 32/2023, Nr. 3, pp. 167-185. <https://doi.org/10.37708/bf.swu.v32i3.9>

Sinani, Arsim, and Rrezehana Hysa. "Mehmet Pashë Deralla, kalorësi i pamposhtur i Shqipërisë." *Diskutime* 7, no. 23 (2018): 140-163.

Demolli, Jakup, 76 vjeçar i intervistuar nga Ali Sh. Berisha në vitin 2005.

Taliri, Azem, Intervistë me telefon – mesengjer. Prishtinë, 28.02.2021